



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA E DOGANES FIER

Nr. 4729 Prot.

Fier, më 19/10/2020

Lënda : *Kërkesë për Shpallje Publike të aktit administrativ (Vendimit të rikuperimit me forcë të detyrimeve të akcizës)*

Drejtuar : PREFEKTURËS SË QARKUT - FIER

Duke vlerësuar me kënaqësi bashkëpunimin e deritanishëm ndërmjet institucioneve tona, në bashkërendimin e veprimeve për zgjidhjen e problemeve të dyanëshme, si dhe me synimin e përmbushjes së misioneve tona të ngarkuara nga Ligji, e shohim të domosdoshëm forcimin e mëtejshëm të këtij bashkëpunimi, pasi nga ana jonë konstatohet se në shume raste nëpërmjet Tij, është mundësuar shlyerja e borxhit doganor.

Në respektim të Ligjit Nr.102, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, neni 48/4 i Tij “Bashkëpunimi ndërmjet autoriteteve” - “*Institucionet publike dhe strukturat e Policisë së Shtetit ndihmojnë autoritetet doganore sa herë që këto të fundit kërkojnë ndihmën e tyre për zbatimin e legjislacionit doganor, në përputhje me funksionet dhe kompetencat e tyre*”, në zbatim të Ligjit Nr.8116, datë 29.03.1996 “Kodi i Procedurës Civile”, neni 131 i Tij “*Kur nuk është i mundur njoftimi sipas dispozitave të mësipërme, njoftimi bëhet në vendbanimin apo vendqëndrimin e marrësit ose në zyrën apo vendin ku ushtron veprimtarinë tregtare, industriale....*”, nenit 162/2 të Ligjit Nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” - “*Njoftimi publik bëhet nëpërmjet*

shpalljes së shkresës në një kënd të posaçëm për njoftimet në selinë e organit dhe në degët ose në zyrat e tij vendore, në prefekturën apo në një vend tjetër dhe ku mendohet se mund të merret dijeni nga ai/ajo, të cilit i drejtohet”, si dhe në zbatim të Udhëzimit Nr. 15, datë 03.12.2018 të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave Tiranë, “Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës”, pika VI.3/b e Tij, “Kur nuk gjendet adresa apo nuk dihet vendndodhja e subjektit debitor, apo ky i fundit nuk gjendet me adresën e kërkuar, njoftimi mund të bëhet edhe përmes lujmërimit publik. Këto njoftime do të vihen në stendën e krijuar posaçërisht për njoftim pranë çdo Dege Doganore ... si dhe në vende publike si në Bashki, Njësi Administrative, në gazetën e pushtetit vendor, në internet dhe me mjete të tjera audiovizive etj. Në këto raste pas kalimit të një periudhe 30 ditore, subjekti debitor konsiderohet i njoftuar”.

Për sa më lart, kërkojmë nga ana Juaj :

♦ “Shpalljen Publike” për një periudhë kohore jo më pak se 30 (Tridhjetë) ditë të aktit administrativ – Vendimit të rikuperimit me forcë të detyrimeve të akcizës Nr. F-1300/1 datë 12/10/2017, me Nr.4242 Prot., datë 12/10/2017; i materializuar nga ana jonë për subjektin “KRISTOEENV” sh.p.k, me NIPT L53318403I, me seli në Fier (Lagjia “Kryengritja e Fierit”, Rruga “Koli Dimo”, Banesa Nr.8/112, Zona Kadastrale nr.8531), me administrator z.Spiro Kristo dhe znj.Afrodides Kristo.

Bashkëngjitur, gjeni kopje të vendimit të lartpërmendur – gjithsej 2 (dy) fletë.

Jemi në pritje të *konfirmimit* nga ana Juaj për datën e shpalljes të vendimit të lartpërmendur.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,

KRYETAR

Olion Kuke



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E FINANCEVE
DREJTORIA E PERGJITHSHEME E DOGANAVE
DEGA DOGANES FIER

Adresa: Lqj. "Sheq i Vogel", Rr. Leonardo Martaldo, Nr. 7, Fier

Tel&Fax 0035534222000

Nr. 4243 prot

Fier, me 12 / 10 / 2017

V E N D I M

per rekuperimin me force te borxhit doganor qe shoqeria "KRISTOEENV" me NIPT L53318403I ka ndaj Deges se Doganes Fier.

Nr. F-1300/1 date 12/10/2017

Sot, me date 12/10/2017, une Kryetari i Deges se Doganes Fier, pasi shqyrtova materialin e plote te dosjes qe i kishte te bente me kundravajtjen doganore te kryer nga shoqeria debitore "KRISTOEENV" me NIPT L53318403I ka ndaj Deges se Doganes Fier.

K O N S T A T O V A S E:

Dega e Doganes Fier, me vendimin e nr saj. 20;21 dt. 10.04.2017 ka vendosur kontabilizmin dhe arketimin e borxhit doganor te perbere ne shumen prej 314.532 leke detyrim doganor akcize dhe 1.129.064 leke penalitet, ne total 1.443.596 leke nga shoqeria debitore "KRISTOEENV" me NIPT L53318403I me seli Lagja Xhevat Nepravishta godine nje kateshe Lushnje

Ky vendim, i eshte njoftuar me vendimet nr. 1300/2 date 10.04.2017 "Njoftim vendimi". Megjithese debitori, shoqeria e mesiperme eshte njoftuar dhe afati ligjor i parashikuar nga ligji ka kaluar, deri me sot nuk jane likujduar vullnetarisht detyrimet per tu paguar sipas vendimit (aktit administriv) te sipercituar.

Nga ana e shoqerise nuk eshte shfrytezuar e drejta e kerkeses ankimore ne respektim te kerkesave te nenit 289 te Kodit Doganor, duke bere ne kete menyre qe vendimi i mesiperme te marre forme te prere.

Ne keto kushte, ne zbatim te nenit 280 te Kodit Doganor si dhe Udhezimit nr.6 date 23.07.2013 te Drejtorise se Pergjithshme te Doganave "Per zbatimin praktik te procedures se evidentimit, kontabilizimit dhe vjeljes se borxhit doganor", me qellim marrjen e masave per rekuperimin me force te borxhit doganor ne shumen totale 1.443.596 leke plus kamat vonesat qe shoqeria "KRISTOEENV" me NIPT L53318403I ka ndaj Deges se Doganes Fier, borxh ky i lindur nga vendimet nr 20;21 dt. 10.04.2017.

V E N D O S A:

1. Te sekuestrohen vlerat monetare, kredite, sendet me vlere te cmuar, dokumentat me ane te te cilave behen pagesa, valutat e huaja te depozituara ne nje bankë, qe i perkasin debitorit, shoqerise se mesiperme, personave te trete ose garantuesve qe kane detyrime kundrejt debitorit
2. Te sekuestrohen mallrat, pasurite e tundshme ose te patundshme qe i perkasin debitorit, shoqerise se mesiperme ose nje pale te trete ose garantuesit qe ka detyrime kundrejt debitorit.
3. Sekuestrimi i mesiperme te kryhet deri ne masen qe te behet i mundur plotesimi i detyrimeve per tu paguar nga shoqeria "KRISTOEENV" me NIPT L53318403I te percaktuara ne vendimet nr 20;21 dt. 10.04.2017, ne shumen totale 1.443.596 lek plus kamat vonesat, ne baze te nenit 280/2 germa "a" te Kodit Doganor, nga momenti i njohimit te borxhit deri ne ditën e likuidimit te tij.

Edison KONOMI

KRYETAR I DEGES DOGANORE

